

20060580736

## L I G J PËR GJYKATAT

### I. PARIMET THEMELORE

#### Neni 1

- (1) Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat në Republikën e Maqedonisë
- (2) Gjykatat janë organe shtetërore autonome dhe të pavarura.

#### Neni 2

- (1) Gjykatat gjykojnë dhe vendimet e tyre i mbështesin në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.
- (2) Gjyqtarët në zbatimin e së drejtës i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

#### Neni 3

Qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor përfshinë:

- zbatimin e paanshëm të së drejtës, pavarësisht nga pozicioni dhe cilësia e palëve,
- mbrojtjen, respektimin dhe përparimin e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore,
- sigurimin e njëjtësisë, barazisë, mosdiskriminimit në çfarëdo lloj baze dhe
- garantimin e sigurisë juridike në bazë të sundimit të së drejtës.

#### Neni 4

Gjykata vendos në procedurë të përcaktuar me ligj:

- për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit dhe interesat juridikisht të bazuara,
- për kontestet midis qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike,
- për veprat penale dhe kundërvajtjet dhe
- për çështje të tjera që me ligj janë vënë në kompetencë të gjyqit.

#### Neni 5

(1) Gjykatat i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarit dhe të drejtat e subjekteve tjera juridike nëse ajo sipas Kushtetutës nuk është në kompetencë të Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

(2) Qytetarëve dhe subjekteve tjera juridike u garantohet mbrojtje gjyqësore në raport me ligjshmërinë e akteve të veçanta të organeve të administratës shtetërore ose organizatave dhe organeve të tjera që kryejnë autorizime publike.

#### Neni 6

(1) Secili ka të drejtë në qasje të barabartë para gjyqit në mbrojtjen e të drejtave të tij dhe interesave të mbështetura juridikisht.

(2) Gjatë vendosjes për të drejtat dhe obligimet qytetare dhe gjatë vendosjes për përgjegjësinë penale, secili ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik në afat të arsyeshëm para gjykatës së pavarur dhe të paanshëm të themeluar me ligj.

(3) Askujt nuk mund t'i kufizohet qasja para gjykatave në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive elementare për shkak të mungesës së mjeteve materiale.

#### Neni 7

Lëndët që vijnë në gjyq për vendosje, shpërndahen midis gjyqtarëve sipas kohës së pranimit të lëndës në gjyq, me përjashtim të çfarëdo ndikimi mbi mënyrën e ndarjes nga ana e kryetarit të gjyqit, të gjyqtarit ose të administratës gjyqësore.

#### Neni 8

(1) Gjykata thirret në jokompetencë gjyqësore vetëm kur me ligj, në mënyrë të prerë është paraparë kompetencë të organit tjetër shtetëror për zgjidhjen e kërkesës konkrete.

(2) Gjykata nuk mund të hedhë poshtë kërkesë për heqjen e së drejtës së caktuar me arsytim se ekziston zbrazëtirë juridike dhe është i detyruar të vendosë për të, duke u thirrur në parimet e përgjithshme të së drejtës, përveç kur ajo në mënyrë të prerë është e ndaluar me ligj.

#### Neni 9

Askush nuk përjashtohet nga pushteti gjyqësor, përveç kur me Kushtetutë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, janë përcaktuar raste të imunitetit para pushtetit gjyqësor.

#### Neni 10

(1) Procedura para gjyqit rregullohet me ligj dhe bazohet mbi parimet si vijon:

- ligjshmërinë dhe legjitimitetin,
- barazinë e palëve,
- gjykimin në afatin e arsyeshem,
- drejtësinë,
- punën publike,
- kontradiktën,
- dyshkallshmërinë,
- fjalën,
- të shprehurit me gojë,
- drejtpërdrejtshmërinë,
- të drejtën e mbrojtjes, respektivisht të përfaqësimit,
- vlerësimin e lirë të dëshmive,
- ekonomicitetin.

(2) Me ligjet për procedurat e caktuara, më për së afërmi përcaktohen parimet e procedurave, mënyrat e mënjanimet të tyre dhe mundësia e shmangies të disa parime të caktuara.

#### Neni 11

(1) Gjyqtari vendos në mënyrë të paanshme me zbatimin e ligjit në bazë të vlerësimit të lirë të dëshmive.

(2) Ndalohet çdo formë e ndikimit mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe autonominë e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit gjyqësor në çfarëdo baze dhe nga cilido subjekt.

#### Neni 12

(1) Puna në gjykata, sipas rregullit, bëhet në seksione të specializuara gjyqësore.

(2) Seksionet e specializuara gjyqësore formohen varësisht nga lloji dhe vëllimi i punës në gjyq, edhe atë në lëmin penal, në krimin e të miturve, lëmin civil dhe ekonomik, kontestet e punës dhe për konteste të llojeve tjera më karakteristike nga fushëveprimi i punës së gjyqeve.

(3) Në suazat e seksionit të specializuar gjyqësor realizohet specializimi i gjyqtarëve.

#### Neni 13

(1) Vendimet gjyqësore kumtohen në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(2) Vendimi gjyqësor i plotfuqishëm ka veprim të paprekshëm juridik.

(3) Vendimin gjyqësor mund ta ndryshojë ose shfuqizojë vetëm gjyqi kompetent në procedurë të përcaktuar me ligj.

(4) Vendimet gjyqësore janë obligative për të gjithë personat juridikë dhe fizikë dhe kanë fuqi më të lartë se vendimet e cilitdo qoftë organ tjetër.

(5) Secili është i detyruar ta respektojë vendimin gjyqësor të plotfuqishëm dhe përmbarues nën kërcënimin e sanksioneve ligjore.

#### Neni 14

Secili është i detyruar të përmbahet nga krijimi ose lejimi i veprimit me të cilin pengohet marrja e vendimit ose përmbarimi i vendimit gjyqësor.

#### Neni 15

Secili organ shtetëror është i detyruar, kur ajo të jetë vënë nën kompetencë të tij, të sigurojë përmbarimin e vendimit gjyqësor. Mbikëqyrjen e përmbarimit të vendimeve gjyqësore e bën gjyqi në pajtim me ligjin.

#### Neni 16

Përmbarimi i vendimit të plotfuqishëm dhe përmbarues gjyqësor zbatohet në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më efikase që është e mundur, dhe ajo nuk mund të pengohet me vendim të cilitdo organi tjetër shtetëror.

#### Neni 17

Askush nuk guxon në mënyrë të paautorizuar të mbajë, të fshehë ose të hapë dërgesë të shkruar gjyqësore ose letër tjetër gjyqësore që nuk i është adresuar atij.

#### Neni 18

(1) Gjykata, paraqet iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e harmonizimit të ligjit me Kushtetutën kur në procedurë do të parashtrahet çështja për përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, për çka i informon drejtpërdrejt gjyqin më të lartë dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë.

(2) Kur gjykata konsideron se ligji që duhet të zbatohet në rastin konkret nuk është në harmoni me Kushtetutën, ndërsa dispozitat kushtetuese nuk mund direkt të zbatohen, do ta ndërpresë procedurën deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

(3) Kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura në rastet nga paragrafi (2) të këtij neni, pala ka të drejtë ankese. Procedura ndaj ankesës është urgjente.

(4) Kur gjykata konsideron se zbatimi i ligjit në rastin konkret është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën, do t'i zbatojë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare, në kushte që ato të mund drejtpërdrejt të zbatohen.

(5) Gjykata, në rastet konkrete, në mënyrë të drejtpërdrejtë i zbaton vendimet definitive dhe përmbaruese të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, të Gjykatës ndëshkuese ndërkombëtare ose të gjykatës tjetër, të cilën kompetencë e pranon Republika e Maqedonisë, nëse vendimi është i përshtatshëm për përmbarim.

#### Neni 19

(1) Gjykatat janë të detyruara midis tyre të ofrojnë ndihmë juridike.

(2) Gjykata e shkallës më të lartë mund të kërkojë nga gjykata e shkallës më të ulët të rajonit të vet të dhëna në lidhje me zbatimin e ligjeve, problemeve që paraqiten gjatë gjykimit, përcjelljen dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, me zvarritjen e procedurës për lëndë të veçanta dhe të dhëna të tjera, ndërsa mund të kryejë edhe shqyrtime të tjera në punën e atyre gjykatave, si dhe të mbajë mbledhje të përbashkëta me qëllim të shqyrtimit të çështjeve të theksuara.

(3) Gjykata e shkallës më të lartë, në realizimin e autorizimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk guxon në çfarëdo mënyre të ndikojë në pavarësinë dhe autonominë e gjykatës së shkallës më të ulët në marrjen e vendimeve për lëndët konkrete.

#### Neni 20

(1) Me kërkesë të gjykatës në realizimin e kompetencës së saj, organet shtetërore dhe personat tjerë juridikë janë të detyruar pa shtyrje t'ia paraqesin të gjitha të dhënat e duhura, shkresat ose dokumentet me të cilat disponojnë, e të cilat janë të nevojshme në procedurë.

(2) Gjykata është e detyruar ta ruajë nga zbulimi i paautorizuar informatën e klasifikuar me shkallë adekuate të fshehtësisë të përcaktuar në pajtim me ligjin, të siguruar nga organet tjera shtetërore ose nga personat juridikë.

(3) Me kërkesë të organit shtetëror dhe të personave të tjerë juridikë, gjykata ofron ndihmë juridike dhe paraqet shkresa të nevojshme për mbajtjen e procedurës, nëse me atë nuk pengohet autonomia dhe pavarësia e saj.

#### Neni 21

Gjykatat u japin ndihmë juridike gjykatave të huaja në procedurë të përcaktuar me ligj, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar më ndryshe.

## II. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCA

### 1. Llojet e gjykatave

#### Neni 22

Në sistemin gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë Gjykatat themelore, Gjykatat e apelit, Gjykata administrative dhe Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 23

(1) Gjykatat themelore themelohen për një ose më shumë komuna, territori i së cilës përcaktohet me këtë ligj.

(2) Gjykatat themelore në pajtim me kompetencën lëndore gjykojnë në shkallë të parë dhe themelohen si gjykata me kompetencë themelore dhe gjykata me kompetencë të zgjeruara.

(3) Në suazat e gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar themelohen seksione gjyqësore të specializuara që do të veprojnë me konteste të llojeve të caktuara.

(4) Gjykatat themelore mund të kenë seksione gjyqësore, të gjykojnë jashtë selisë së gjykatës, si dhe të kenë ditë gjyqësore jashtë selisë së gjykatës.

#### Neni 24

(1) Gjykatat e apelit themelohen për rajonin e më shumë gjykatave të shkallës së parë të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Selitë e gjykatave të apelit janë në Manastir, Gostivar, Shkup dhe Shtip.

#### Neni 25

(1) Gjykata administrative themelohet dhe ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Selia e Gjykatës administrative është në Shkup.

#### Neni 26

(1) Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë e ushtron pushtetin gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Selia e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë është në Shkup.

#### Neni 27

(1) Gjykata ka vulë në të cilën është emri i gjykatës, selia e saj, stema dhe emri Republika e Maqedonisë.

(2) Në ndërtesën ku është vendosur gjykata janë të vendosur emri Republika e Maqedonisë, emri i gjykatës, selia e gjykatës, stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë.

(3) Në gjykata, selia e së cilës është në territorin e njërive të vetadministrimit lokal në të cilat përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj është gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve, vula e gjykatës, emri dhe selia e gjykatës janë të shkruara, respektivisht të vendosura edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

## 2. Kompetenca vendore

### Neni 28

(1) Gjykatat themelore themelohen për këto territore të komunave si vijon:

1. Gjykata themelore në Berovë për territorin e komunave: Berovë dhe Pehçevë;
2. Gjykata themelore në Manastir, për territorin e komunave: Manastir, Mogilë Novaci dhe Demir Hisar, me seksionin gjyqësor në Demir Hisar;
3. Gjykata themelore në Vinicë për territorin e komunës Vinicë;
4. Gjykata themelore në Veles për territorin e komunave: Veles, Gradsko dhe Çashkë;
5. Gjykata themelore në Gjevgjeli për territorin e komunave: Gjevgjeli, Bogdanci, Dojran dhe Vallandovë, me Seksionin gjyqësor në Vallandovë;
6. Gjykata themelore në Gostivar për territorin e komunave: Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë dhe Rostushë;
7. Gjykata themelore në Dibër për territorin e komunave: Dibër dhe Zhupë;
8. Gjykata themelore në Dellçevë për territorin e komunave: Dellçevë dhe Makedonska Kamenicë;
9. Gjykata themelore në Kavadar për territorin e komunave: Kavadar dhe Rosoman;
10. Gjykata themelore në Kërçovë për territorin e komunave: Kërçovë, Vraneshticë, Drugovë, Zajas, Oslomej, Pllasnicë dhe Makedonski Brod, me Seksion gjyqësor në Makedonski Brod;
11. Gjykata themelore në Koçan për territorin e komunave: Koçan, Zrnovci dhe Çeshinovë-Obleshevë;
12. Gjykata themelore në Kratovë për territorin e Komunës Kratovë;
13. Gjykata themelore në Kriva Pallankë për territorin e komunave: Kriva Pallankë dhe Rankovc;
14. Gjykata themelore në Kumanovë për territorin e komunave: Kumanovë, Likovë dhe Nagoriçan i Vjetër;
15. Gjykata themelore në Krushevë për territorin e Komunës Krushevë;
16. Gjykata themelore në Negotinë për territorin e komunave: Negotinë dhe Demir Kapi;
17. Gjykata themelore në Ohër për territorin e komunave: Ohër dhe Debërc;
18. Gjykata themelore në Prilep për territorin e komunave: Prilep, Dolnen dhe Krivogashtan;
19. Gjykata themelore në Radovish për territorin e komunave: Radovish dhe Konçe;
20. Gjykata themelore në Resnjë për territorin e Komunës Resnjë;
21. Gjykata themelore në Sveti Nikollë për territorin e komunave: Sveti Nikollë dhe Llozovë;
22. Gjykata themelore Shkup I - Shkup për territorin e komunave: Qendër, Karposh, Gjoçe Petrov, Saraj, Kisella Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizare, Çuçer Sandevë, Sopište, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Haraçinë;
23. Gjykata themelore Shkup II - Shkup për territorin e komunave: Qendër, Karposh, Gjoçe Petrov, Saraj, Kisella Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizare, Çuçer Sandevë, Sopište, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Haraçinë;
24. Gjykata themelore në Strugë për territorin e komunave: Strugë dhe Vevçan;
25. Gjykata themelore në Strumicë për territorin e komunave: Strumicë, Vasilevë, Bosillovë dhe Novo Sellë;
26. Gjykata themelore në Tetovë për territorin e komunave: Tetovë, Bogovinë, Brvenicë, Zhelinë, Jegunovc dhe Tearcë dhe

27. Gjykata themelore në Shtip për territorin e komunave: Shtip, Karbinc dhe Probishtip, me Seksion gjyqësor në Probishtip.

(2) Seksioni Gjyqësor i gjykatës themelore ushtron kompetenca të gjykatës themelore për territorin e komunave për të cilat është themeluar.

(3) Në rast të formimit të komunave të reja, territoret e gjykatave të përcaktuara nga paragrafi (1) të këtij neni ngelin të pandryshueshme.

#### Neni 29

Gjykatat e apelit themelohen për territoret vijuese:

1. Gjykata e apelit në Manastir për territoret e gjykatave themelore në Manastir, Krushevë, Ohër, Prilep, Resnjë dhe Strugë;

2. Gjykata e apelit në Gostivar për territoret e gjykatave themelore në Gostivar, Tetovë, Kërçovë dhe Dibër;

3. Gjykata e apelit në Shkup për territoret e gjykatave themelore në Veles, Gjevgjeli, Kavadar, Kratovë, Kriva Pallankë, Kumanovë, Negotin, Shkup I - Shkup dhe Shkup II - Shkup dhe

4. Gjykata e apelit në Shtip për territoret e gjykatave themelore në Berovë, Vinicë, Dellçevë, Koçan, Radovish, Sveti Nikollë, Strumicë dhe Shtip.

## 2. Kompetenca lëndore e gjykatave

#### Neni 30

(1) Gjykatat themelore me kompetencë themelore për rajonet për të cilat themelohen, janë kompetent të vendosin në shkallë të parë për veprat penale dhe kundërvajtje, edhe atë:

- për vepra penale për të cilat me ligj si dënim kryesor është përcaktuar dënim me burg deri në 5 vjet, nëse për disa vepra penale nuk është paraparë kompetencë e gjykatës tjetër,

- për vepra penale për të cilat me ligj të veçantë është përcaktuar kompetencë e gjyqit me kompetencë themelore,

- të zbatojnë hetim ose veprime hetuesie për vepra penale nga kompetencat e saj,

- për të gjitha llojet e kundërvajtjeve, përveç për kundërvajtje të cilat me ligj janë vënë në kompetencë të organit të administratës shtetërore ose organizatës ose organit tjetër që kryen autorizime publike dhe

- për ankesa dhe kundërshtime për procedurat për të cilat janë kompetent këto gjykata.

(2) Gjykatat themelore me kompetencë themelore janë kompetent të vendosin në shkallë të parë për kontestet civile, edhe atë:

- për konteste pronësore-juridike dhe marrëdhënie të tjera civile-juridike të personave fizikë dhe juridikë, e cila vlerë është deri në 15.000 euro në kundërvlerë të denarit, nëse me ligj nuk është paraparë si kompetencë e gjyqit tjetër,

- për konteste për përcaktimin dhe kontestimin e atësisë, amësisë, konstatimin e ekzistimit të kurorës, për prishjen e kurorës dhe shkëputjen e kurorës,

- për asistencë ligjore,

- për ruajtje dhe edukim të fëmijëve,

- për pengim të zotërimit,

- për asistencë gjatë gjithë jetës,

- për kompensim të dëmit që nuk tejkalon 15.000 euro në kundërvlerë të denarit,

- në procedurë për sigurim dhe përmbarim,

- për marrëdhënie pune,

- në konteste të marrëdhënieve juridike-trashëguesë,

- në çështje jashtëkontestimore dhe trashëgimie,

- të mbajnë tapë, dhe

- për çështje tjera të përcaktuara me ligj.

### Neni 31

(1) Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përveç kompetencës së përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji për territoret për të cilat janë themeluar, janë kompetente të vendosin për veprat penale, edhe atë:

- për ato, për të cilat me ligj është paraparë dënim me burg mbi 5 vjet dhe për vepra penale dhe kundërvajtje të kryera nga personat e mitur,
- të zbatojnë hetim ose veprime hetuesie për vepra penale nga kompetencat e saj,
- të veprojnë ndaj lëndëve për ekstradim,
- ndaj ankesave dhe kundërshtimeve për procedurat për të cilat janë kompetente dhe
- të vendosin për procedurat për ndihmë juridike ndërkombëtare të përcaktuar me ligj.

(2) Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përveç kompetencës së përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji për territoret për të cilat janë themeluar, janë kompetent të vendosin për konteste civile, edhe atë:

- për konteste në marrëdhëniet pronësore-juridike dhe marrëdhënie tjera juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, e cila vlerë është mbi 15.000 euro në kundërvlerë të denarit, nëse me ligj nuk është paraparë kompetencë e gjyqit tjetër,

- në kontestet tregtare, në të cilat të dy palët janë persona juridikë ose organe shtetërore, si dhe konteste të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të ngjashme dhe të drejtave të pronësisë industriale,

- mban regjistër gjyqësor për partitë politike,
- në procedurë për falimentim dhe likuidim,
- në konteste për përcaktimin dhe sigurimin e përmbarimit të dhunshëm dhe
- për konteste të personave juridikë të vendit dhe të huaj që dalin nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella ekonomike, respektivisht tregtare.

(3) Kompetencën nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni do ta kryejnë gjykatat, edhe atë: Gjykata themelore e Manastirit edhe për territorin e Gjykatës themelore në Resnjë; Gjykata themelore e Prilepit edhe për territorin e Gjykatës themelore në Krushevë; Gjykata themelore e Ohrit edhe për territorin e Gjykatës themelore në Ohër; Gjykata themelore e Gostivarit edhe për territorin e gjykatave themelore në Kërçovë dhe Dibër; Gjykata themelore e Tetovës edhe për territorin e Gjykatës themelore në Tetovë; Gjykata themelore e Kumanovës edhe për territorin e gjykatave themelore në Kriva Pallankë dhe Kratovë; Gjykata themelore e Koçanit edhe për territorin e gjykatave themelore në Berovë, Vinicë dhe Delçevë; Gjykata themelore e Velesit edhe për territorin e gjykatave themelore në Gjevgjeli, Kavadar dhe Negotinë; Gjykata themelore e Strumicës edhe për territorin e Gjykatës themelore në Radovish dhe Gjykatës themelore në Shtip edhe për territorin e Gjykatës themelore në Sveti Nikollë.

### Neni 32

(1) Në gjykatat themelore në Manastir, Tetovë, Shkup I, Strumicë dhe Shtip formohen seksione të specializuara gjyqësore, kompetent për gjykim të veprave nga lëmi i krimit të organizuar, edhe atë: Gjykata themelore e Manastirit me kompetencë në territorin e gjykatave themelore në Manastir, Krushevë, Ohër, Prilep, Resnjë dhe Strugë; Gjykata themelore e Tetovës me kompetencë në territorin e gjykatave themelore të Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe të Dibrës; Gjykata themelore Shkupi I me kompetencë në territorin e gjykatave themelore të Velesit, Gjevgjelisë, Kavadarit, Kratovës, Kriva Pallankës, Kumanovës, Negotinës, Shkupit I - Shkup dhe Shkupit II – Shkup; Gjykata themelore e Strumicës me kompetencë në territorin e Gjykatës themelore në Radovish dhe Gjykata themelore e Shtipit me kompetencë në territorin e gjykatave themelore të Berovës, Vinicës, Dellçevës, Koçanit dhe Sveti Nikollës.

(2) Gjykatat nga paragrafi (1) të këtij neni janë kompetent për mbajtjen e regjistrit gjyqësor për partitë politike në territorin e tyre.

(3) Gjykata themelore Shkupi I - Shkup është gjykatë penale me kompetencë themelore dhe të zgjeruar për territorin e komunave Qendër, Karposh, Gjorçe Petrov, Saraj, Kisella Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizare, Çuçer Sandevë, Sopsishte, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Haraçinë;

(4) Gjykata themelore Shkup II - Shkup është gjykatë civile me kompetencë themelore dhe të zgjeruar për territorin e komunave Qendër, Karposh, Gjorçe Petrov, Saraj, Kisella Vodë, Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizare, Çuçer Sandevë, Sopsishte, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden dhe Haraçinë;

#### Neni 33

Gjykatat e Apelit janë kompetente:

- 1) të vendosin ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatave themelore të territorit të tyre;
- 2) të vendosin për ndeshje kompetencash midis gjykatave të shkallës së parë të territorit të tyre dhe
- 3) të kryejnë punë tjera të përcaktuara me ligj.

#### Neni 34

Gjykata administrative është kompetente të vendos:

- për ligjshmërinë e akteve të caktuara të nxjerra në procedurën zgjedhore dhe të akteve të caktuara për zgjedhje, emërim dhe shkarkime të bartësve të funksioneve publike, nëse ajo është përcaktuar me ligj, si dhe për aktet për emërim, caktim dhe shkarkim të nëpunësve udhëheqës shtetërorë, nëse më ndryshe nuk është përcaktuar me ligj,

- për ligjshmërinë e akteve të organeve shtetërore, të Qeverisë dhe të bartësve të autorizimeve publike, të nxjerra në formë të dispozitës nëse ato i rregullojnë marrëdhëniet e caktuara,

- për kontest që do të dalë nga zbatimi dhe realizimi i dispozitave të marrëveshjeve të koncesioneve, marrëveshjeve për furnizimet publike që janë me interes publik, dhe për secilën marrëveshje në të cilën njëra nga palët është organ shtetëror, organizatë me autorizime publike, ndërmarrje publike, komunat dhe Qyteti i Shkupit të lidhur me interes publik ose për shkak kryerjes së shërbimit publik (në tekstin e më tejme: marrëveshje administrative),

- kundër akteve të caktuara të organeve të administratës shtetërore, Qeveria, organet tjera shtetërore, komunat dhe Qyteti i Shkupit, organizatat e përcaktuara me ligj dhe të personave juridikë dhe personave tjerë në kryerjen e autorizimeve publike (bartës të autorizimeve publike), kur për vendosje në shkallë të dytë kundër aktit të tillë, nuk është siguruar ndonjë mbrojtje tjetër juridike dhe

- vendos për ndeshjen e kompetencave midis organeve të Republikës, midis komunave dhe Qytetit të Shkupit, midis komunave të Qytetit të Shkupit edhe për kontestet e krijuara për ndeshje të kompetencave midis komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe bartësve të autorizimeve publike, nëse ajo është përcaktuar me ligj, nëse me Kushtetutë ose me ligje nuk është përcaktuar tjetër mbrojtje gjyqësore.

#### Neni 35

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë është kompetent:

1) të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të vet kur ajo është përcaktuar me ligj;

2) të vendosë në shkallë të tretë dhe të fundit ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatave të apelit;

3) të vendosë në shkallë të dytë ndaj ankesës së vendimit të Gjykatës administrative në rastet e përcaktuara me ligj;

4) të vendosë ndaj mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjyqeve dhe vendimeve të këshillave të tyre kur ajo është përcaktuar me ligj;



5) të vendosë për ndeshje të kompetencave midis gjykatave themelore nga territori i gjykatave të ndryshme të apelit, ndeshje të kompetencave midis gjykatave të apelit, ndeshje të kompetencave midis Gjykatave administrative dhe gjykatës tjetër, dhe të vendosë për bartjen e kompetencës vendore te këto gjykata;

6) të vendosë ndaj kërkesave të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën për cenimin e të drejtës së gjykimit në afatin e arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë dhe

7) të kryejë punë tjera të përcaktuara me ligj.

#### Neni 36

(1) Pala që konsideron se gjykata kompetente e ka cenuar të drejtën e gjykimit në afatin e arsyeshëm, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e gjykimit në afatin e arsyeshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatën më të lartë.

(2) Gjykata më e lartë drejtpërdrejt vepron ndaj kërkesës në afat prej gjashtë muajve nga paraqitja e saj dhe vendos nëse gjykata më e ulët e ka cenuar të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm.

(3) Nëse gjykata më e lartë konstaton cenimin e të drejtës për gjykim në afatin e arsyeshëm, me vendim do të gjykojë kompensim të drejtë për paraqitësin e kërkesës.

(4) Kompensimi i drejtë bie në barrë të Buxhetit gjyqësor.

#### Neni 37

(1) Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë në seancë të përgjithshme:

- përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore ndaj çështjeve me rëndësi për sigurimin e qëndrimit unik në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave me iniciativë të tyre ose me iniciativë të seancave të gjyqtarëve ose seksioneve gjyqësore të gjyqtarëve,

- jep mendim ndaj propozimeve të ligjeve dhe dispozitave kur me ato përcaktohen çështjet me rëndësi për punën e gjykatave,

- shqyrton çështje në lidhje me punën e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikës gjyqësore,

- nxjerr rregullore pune për punën e vet,

- nxjerr program për punën e gjykatës,

- i paraqet propozim Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për udhëzimin e përkohshëm të gjyqtarëve në gjykatë tjetër,

- paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës disiplinore kundër gjyqtarit,

- paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës për konstatimin e joprofesionalitetit dhe kryerjen e funksionit të gjyqtarit në mënyrë të pandërgjegjshme,

- paraqet iniciativë për ngritjen e procedurës para Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për konstatimin e humbjes përgjithmonë të aftësisë për kryerjen e funksionit gjyqtar,

- emëron përbërjen e Këshillit për vendosje ndaj ankesave kundër vendimit të Këshillit gjyqësor për shkarkimin e gjyqtarit ose shqiptimin e masës disiplinore,

- vendos ndaj kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimeve të këshillave të tyre,

- vendos ndaj kërkesave për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë,

- e shqyrton raportin për punën e vet dhe raportet për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë nga aspekti i përditësimit dhe kualitetit të punës, sjell konkluzë ndaj tyre dhe kujdeset për zbatimin e tyre,

- bën punë të tjera, të përcaktuara me ligj.

(2) Qëndrimet parimore dhe mendimet parimore juridike që i miraton Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë në seancë të përgjithshme, janë të detyrueshme për të gjitha këshillat e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë.

### III. GJYQTARËT DHE GJYQTARËT POROTË

#### Neni 38

(1) Funksionin e gjyqtarit e kryejnë gjyqtarët. Gjyqtari zgjidhet pa kufizimin e zgjatjes së mandatit.

(2) Gjyqtarët veprojnë në të gjitha çështjet që me ligj janë vënë në kompetencë gjyqësore.

(3) Në gjykim marrin pjesë edhe gjyqtarët-porotë kur ajo është përcaktuar me ligj.

#### Neni 39

(1) Funksionin e gjyqtarit, gjyqtari e ushtron në gjykatën në të cilin është zgjedhur.

(2) Gjyqtari, sipas rregullit, zgjidhet që të gjykojë në lëmin adekuat.

(3) Gjyqtari nuk mund të transferohet nga një gjykatë në gjykatë tjetër në kundërshtim me vullnetin e tij.

(4) Sistemimi i gjyqtarëve bëhet me sistemim vjetor për punë, të cilin e përcakton kryetari i gjykatës pas sigurimit paraprak të mendimit nga seanca e gjyqtarëve, respektivisht seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, duke mbajtur llogari për përcaktimin e gjyqtarit për specializim në fushën penale, civile, ekonomike, administrative dhe sferat tjera juridike.

(5) Gjatë përcaktimit të kryetarëve të seksioneve dhe njësive të specializuara, respektohet përvoja gjyqësore dhe rezultatet në punë.

(6) Gjyqtari, nuk mund të transferohet nga një gjykatë në gjykatë tjetër kundër vullnetit të tij.

(7) Gjyqtari mund të kërkojë transferim nga njëri seksion në seksionin tjetër.

(8) Me përjashtim, gjyqtari mund të transferohet në seksion tjetër gjyqësor kundër vullnetit të tij me vendim të arsyetuar me shkrim të kryetarit të gjykatës, ndërsa pas mendimit të siguruar paraprakisht nga seanca e gjyqtarëve, kur atë e kërkon vëllimi i zmadhuar dhe lënda e punës në gjykatë, por më së shumti për periudhë njëvjeçare.

(9) Me përjashtim, gjyqtari i gjykatës së apelit dhe i gjykatës themelore, mund të udhëzohet përkohësisht, por më së shumti në periudhë prej një viti, të gjykojë në gjykatë tjerë të shkallës së njëjtë ose në gjykatë më të ulët ose nga një seksion special në seksion tjetër, kur për shkak të pengimit dhe përjashtimit të gjyqtarit ose për shkak të vëllimit mjaft të zmadhuar, azhurnitetit të zvogëluar ose për shkak të lëndëve të komplikuar, është vënë në pyetje puna vijuese e gjyqit.

(10) Dërgimin e përkohshëm të gjyqtarit nga paragrafi (9) të këtij neni e bën Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe për atë menjëherë e informon kryetarin e gjykatës nga i cili dërgohet dhe kryetarin e gjykatës ku përkohësisht dërgohet gjyqtari.

(11) Kundër vendimit nga paragrafët (4), (7) dhe (8) të këtij neni gjyqtari mund të paraqesë kundërshtim në afat prej tre ditëve deri në seancën e përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, që është e detyruar të vendosë ndaj kundërshtimit në afat prej shtatë ditëve.

(12) Kundër vendimeve nga paragrafi (9) të këtij neni, gjyqtari mund të paraqesë kundërshtim në afat prej tre ditëve deri në seancën e përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, që është e detyruar të vendosë ndaj kundërshtimit në afat prej shtatë ditësh. Vendimi i Këshillit gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është definitiv.

#### Neni 40

Në rast të heqjes ose riorganizimit të gjykatës, Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë do ta sistemojë gjyqtarin e asaj gjykate në gjykatë tjetër në shkallë të njëjtë ose më të ulët.

### 1. Zgjedhja e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë

#### Neni 41

(1) Gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj.

(2) Zgjedhjen, respektivisht shkarkimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë e boton në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” në afat prej 15 ditësh nga dita e zgjedhjes së bërë, respektivisht shkarkimit.

#### Neni 42

(1) Gjyqtarët porotë i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

#### Neni 43

(1) Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, nuk guxon të bëhet diskriminim në raport të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës së pasurisë dhe asaj shoqërore.

(2) Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, pa u shkelur kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësim adekuat i qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive.

(3) Për gjyqtar ose gjyqtar porotë nuk mund të zgjidhet personi i cili me gjyqtarin ose gjyqtarin porotë në të njëjtin gjykatë është në lidhje familjare në linjë të drejtë ose në linjën anësore deri në shkallën e tretë ose është çift bashkëshortor.

#### Neni 44

(1) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me vendim e përcakton numrin e gjyqtarëve në secilën gjykatë, me mendim të marrë nga seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë dhe mendim nga seanca e gjyqtarëve të gjykatës adekuate.

(2) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me propozim të seancave nga gjykatat themelore dhe të apelit, me vendim e përcakton numrin e gjyqtarëve porotë në secilën gjykatë.

(3) Vendimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni shpallen në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

#### Neni 45

Gjyqtar mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet si vijon:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase,
- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- të ketë diplomë universitare për jurist të diplomuar në Republikën e Maqedonisë ose diplomë të nostrifikuar nga fakulteti i huaj juridik dhe
- të ketë të dhënë provimin e judikaturës në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 46

(1) Kushtet e veçanta për zgjedhjen e gjyqtarit janë:

- për gjyqtar në Gjykatën themelore mund të zgjidhet personi i cili e ka mbaruar aftësimin në Akademinë për aftësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë,

- për gjyqtar të Gjykatës së apelit mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej së paku pesë vjet stazh gjyqtari me rezultate të dëshmuara në punë ose tetë vjet përvojë pune në punë juridike pas dhënies së provimit të judikaturës,

- për gjyqtar në Gjykatën administrative mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej së paku pesë vjet në gjykatë me rezultate të dëshmuara në punë, ose së paku tetë vjet stazh pas dhënies së provimit të judikaturës, në çështje administrative, ose është profesor universitar nga lëmi i drejtësisë me titull shkencor doktor i shkencave juridike dhe

- për gjyqtar të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, mund të zgjidhet personi i cili ka përvojë pune prej së paku tetë vjet stazh gjyqtari me rezultate të dëshmuara në punë ose 12 vjet përvojë pune me rezultate dëshmuuese në çështje juridike pas dhënies së provimit të judikaturës.

(2) Për gjyqtar në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet edhe profesor universitar ordinar dhe inordinar që ka dhënë mësim më shumë se dhjetë vjet lëndë juridike lidhur me praktikën gjyqësore.

#### Neni 47

(1) Kryetar i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në kushte, në procedurë dhe në mënyrë siç bëhet zgjedhja e gjyqtarit në gjykatën adekuate. Kryetari i gjykatës zgjidhet me mandat katër vjeçar, me mundësi që përsëri të zgjidhet në të njëjtin funksion edhe katër vjet.

(2) Kryetari i gjykatës ka status dhe funksion të gjyqtarit të parë të gjykatës adekuate.

(3) Kandidati për kryetar gjyqësor, fletëparaqitjes dhe dokumenteve të tjera ia bashkëngjit programin për punë gjatë mandatit.

(4) Kryetari i gjykatës, i cili nuk do të zgjidhet për herë të dytë në të njëjtin funksion, vazhdon të punojë si gjyqtar në gjykatën në të cilën paraprakisht e ka ushtruar funksionin gjyqësor.

#### Neni 48

(1) Për gjyqtar porotë mund të zgjidhet shtetasi i moshës madhore i Republikës së Maqedonisë me shkollë të kryer minimale të mesme, i cili aktivisht e zotëron gjuhën maqedonase, gëzon autoritet për kryerjen e funksionit dhe i cili nuk është më i vjetër se 60 vjet.

(2) Gjyqtari porotë për gjykimin e të miturve zgjidhet nga radhët e personave me përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve.

#### Neni 49

Gjyqtari porotë zgjidhet për kohë katërvjeçare me mundësi rizgjedhjeje.

#### Neni 50

(1) Para marrjes së detyrës, gjyqtari dhe gjyqtari porotë jep deklaratë solemne, si vijon:

“Deklaroj dhe betohem se në kryerjen e funksionit të gjyqtarit do t’i respektoj Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, se do të gjykoj në mënyrë ligjore, me nder, me ndërgjegje, në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi dhe se do t’i mbroj liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit”.

(2) Kur jep deklaratë solemne gjyqtari mban togë. Gjyqtari, deklaratën solemne e jep individualisht para Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Gjyqtarët-porotë, deklaratën solemne e japin para kryetarit të gjykatës në të cilën zgjidhen.

(4) Gjyqtari dhe gjyqtari-porotë deklaratën solemne e japin në gjuhën maqedonase dhe e nënshkruajnë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(5) Gjatë zgjedhjes së gjyqtarit dhe gjyqtarit-porotë në gjykatë e cila gjendet në territorin e njësisë së vetadministrimit lokal ku së paku 20% nga qytetarët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, gjyqtari dhe gjyqtari-porotë pjesëtarë i asaj bashkësie, deklaratën solemne e japin në gjuhën maqedonase, ndërsa e nënshkruajnë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie.

(6) Kopje e deklaratës solemne i jepet gjyqtarit dhe gjyqtarit-porotë të porsazgjedhur.

### IV. TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE IMUNITETI

#### Neni 51

Gjyqtarët mund të themelojnë shoqata me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre, përparimit të përsosmërisë profesionale dhe për shkak të mbrojtjes së pavarësisë dhe unitetit të funksionit të gjyqtarit.

#### Neni 52

(1) Funkcioni gjyqtar është jokohorent me funksionin deputet, respektivisht anëtar i këshillit të komunës respektivisht i Qytetit të Shkupit, dhe me funksionet në organet shtetërore, të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

(2) Gjyqtari nuk mund të ushtrojë çfarëdo funksioni ose profesioni tjetër publik, përveç funksionit të përcaktuar me ligj, e që nuk është në kundërshtim me pavarësinë dhe mëvetësinë e tyre në kryerjen e funksionit të gjyqtarit.

(3) Gjyqtari nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë tregtare ose personit tjetër juridik i cili është themeluar për qëllime fitimprurëse.

(4) Gjyqtari mund të jetë edukator ose të mbajë ligjërata në Akademinë për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë dhe në institucione të larta arsimore dhe të marrë pjesë në projekte të caktuara shkencore.

(5) Për kryerjen e aktiviteteve në institucionin e lartë arsimor, pëlqim jep Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

(6) Gjyqtari nuk guxon të anëtarësohet dhe të kryejë funksione në parti politike ose të bëjë aktivitete partiake dhe politike.

#### Neni 53

(1) Nëse gjyqtari është emëruar ose zgjedhur anëtar i Këshillit gjyqësor i Republikës së Maqedonisë ose gjyqtar i gjykatës ndërkombëtare, gjyqtar i Gjykatës kushtetuese ose drejtor i Akademisë për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, funksioni gjyqtar i pushon gjatë kohës deri sa e ushtron detyrën për të cilën është emëruar, respektivisht zgjedhur.

(2) Pas skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në gjykatën prej ku ka shkuar në kryerjen e detyrës tjetër.

#### Neni 54

Gjyqtari ka të drejtë dhe obligim në aftësimin e vazhdueshëm profesional gjatë kohës së funksionit gjyqtar në pajtim me ligjin.

#### Neni 55

(1) Gjyqtari ka legjitimacion gjyqësor, të cilin e lëshon dhe e heq Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

(2) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me akt e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit gjyqësor, mënyrën e lëshimit dhe të heqjes së tij.

#### Neni 56

(1) Të drejtat e veçanta të gjyqtarit në kryerjen e funksionit gjyqtar janë:

- të mund të hyjë dhe të ketë kalim të lirë në stacionet, aeroportet, portet, vetëm me tregimin e legjitimacionit gjyqësor;

- të ketë të drejtë në leje zyrtare për mbajtjen e armës dhe furnizimin e municionit adekuat;

- pa pagesë ta përdor komunikacionin publik, tokësor ose ujor në territorin gjyqësor në të cilin e ushtron funksionin gjyqtar, në rastet e nevojës zyrtare dhe në rast të nenit 39 të këtij ligji,

- të ketë mbrojtje të veçantë të personalitetit të tij, familjes dhe pronës, me kërkesë të tij ose me kërkesë të kryetarit të gjykatës në policinë e vendbanimit, çdo herë kur për atë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për sigurinë e tij dhe,

- të ketë dokument zyrtar të udhëtimit.

(2) Për të drejtat e veçanta nga paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni, dispozita më të përafërta nxjerr Ministria e Drejtësisë.

(3) Të drejtat e veçanta nga paragrafi (1) alineja 4 kanë të bëjnë edhe për gjyqtarin në pension.

#### Neni 57

(1) Gjyqtari kur gjykon, është i detyruar të mbajë veshje të veçantë gjyqësore (TOGË) me të cilën veçohet nga pjesëmarrësit tjerë në procedurë.

(2) Aktin për dukjen dhe kushtet me të cilat mbahet veshja gjyqësore nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton ministri i Drejtësisë.

#### Neni 58

Gjyqtari, në lidhje me kryerjen e funksionit gjyqtar, nuk guxon të pranojë dhurata ose të shfrytëzojë beneficione dhe lehtësime të tjera në kryerjen e funksionit gjyqtar.

#### Neni 59

Gjyqtarët i gëzojnë të gjitha të drejtat e marrëdhënies së punës që u takojnë sipas ligjit.

#### Neni 60

(1) Lartësia e rrogës së gjyqtarit përcaktohet varësisht nga:

- lloji i gjykatës,
- seksioni i specializuar gjyqësor (lloji i lëndëve ndaj të cilave vepron),
- detyrat e brendshme në gjykatë (kryetar i: gjykatës, i seksionit, i njësisë dhe i këshillit),
- përvoja gjyqësore,
- titujve shkencor-profesional dhe specializimit dhe
- rezultatet e arritura në ushtrimin e funksionit gjyqtar.

(2) Rroga e gjyqtarit gjatë kohëzgjatjes së funksionit të gjyqtarit nuk guxon të zvogëlohet, përveç në rastet e përcaktuara me ligj.

(3) Lartësia e rrogës së gjyqtarit përcaktohet në mënyrë që gjyqtarit i siguron mbrojtje nga presionet dhe ndikimet gjatë veprimit dhe vendosjes.

(4) Rrogat dhe kompensimet e tjera të gjyqtarëve rregullohen me ligj.

#### Neni 61

(1) Kur gjyqtari, sipas nevojës së detyrës, përkohësisht është dërguar që funksionin e gjyqtarit ta ushtrojë jashtë vendbanimit, ka të drejtë në kompensim për shpenzime të zmadhuara për banimin e tij ose kompensim të shpenzimeve për transport.

(2) Gjyqtari ka të drejtë në kompensim për shpenzime të shpërnguljes në rast nga paragrafi (1) i këtij neni për atë ose për familjen e tij, si dhe në kompensim në rastet kur zgjidhet ose sistemohet në gjykatë tjetër.

(3) Ministri i Drejtësisë, me akt nënligjor e përcakton lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

#### Neni 62

(1) Gjyqtari, i cili nuk ka banesë të tij personale në selinë e gjykatës, ka të drejtë në shfrytëzimin e banesës adekuate zyrtare.

(2) Deri në realizimin e së drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni, gjyqtari ka të drejtë në kompensim të shpenzimeve reale të rrugës.

#### Neni 63

Për të drejtat nga neni 61 dhe 62 të këtij ligji me kërkesë të gjyqtarit, vendos Këshilli buxhetor i gjykatës.

#### Neni 64

(1) Gjyqtarët-porotë kanë të drejtën e kompensimit për kryerjen e punëve të gjyqtarit-porotë.

(2) Ministri i Drejtësisë nxjerr dispozita më të përafërta për kompensimet e gjyqtarëve-porotë.

#### Neni 65

- (1) Gjyqtarët, në kryerjen e funksionit të gjyqtarit gëzojnë imunitet.
- (2) Gjyqtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale për mendimin e shprehur dhe për vendosje gjatë marrjes së vendimit gjyqësor.
- (3) Gjyqtari nuk mund të paraburgoset pa leje të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse haset në kryerjen e veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet.
- (4) Për heqjen e imunitetit të gjyqtarit vendos Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.
- (5) Procedura për vendosje për heqje imuniteti të gjyqtarit është urgjente.

#### Neni 66

Gjyqtari-porotë nuk mund të thirret në përgjegjësi për mendimin e shprehur dhe për vendosje gjatë marrjes së vendimit gjyqësor.

#### Neni 67

- (1) Gjyqtari largohet nga kryerja e funksionit të gjyqtarit gjatë kohës sa gjendet në paraburgim.
- (2) Gjyqtari mund të largohet nga kryerja e funksionit të gjyqtarit gjatë kohës sa zgjat hetimi për veprën penale, ose kur është ngritur procedurë penale ose procedurë për shkarkimin e tij.
- (3) Vendim për largim të gjyqtarit nga funksioni gjyqësor, në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni merr Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 68

- (1) Parashtesat në lidhje me kryerjen e funksionit të gjyqtarit doemos duhet të shqyrtohen shpejt dhe drejtë dhe pa publicitet të procedurës nga ana e organeve të cilat janë paraqitur.
- (2) Gjyqtari, kundër të cilit është paraqitur parashtesa, ka të drejtë në përgjigje.

#### Neni 69

Kundër gjyqtarit ose gjyqtarit-porotë nuk mund të mbahet procedurë për kompensim të dëmit ose procedurë tjetër nga ana e palës që është e pakënaqur nga vendimi i gjyqtarit.

#### Neni 70

- (1) Për dëmin që gjyqtari ose gjyqtari-porotë në kryerjen e funksionit do t'ua shkaktojë qytetarëve ose personave juridikë me punën e paligjshme, përgjegjëse është Republika e Maqedonisë.
- (2) Kur dëmi nga paragrafi (1) i këtij neni është shkaktuar me cenim të rëndë dhe të pafalshëm të ligjit, për shkak të të cilit ngrihet procedurë për shkarkim, Republika e Maqedonisë nëpërmjet padisë mund të kërkojë nga gjyqtari kthimin e shumës së dëmit të paguar nga paragrafi (1) në lartësi që do ta përcaktojë gjyqtari në pajtim me parimin e së drejtës.

#### Neni 71

- (1) Bursa gjyqësore i ndahet gjyqtarit për studime pasuniversitare në drejtësi dhe për studime specialistike të drejtësisë në vend, ose jashtë vendit, respektivisht për aftësim profesional në ndonjë fushë tjetër profesionale që është e lidhur me punën e gjyqtarit, ndërsa nuk mund të realizohet në suazat e Akademisë për aftësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.
- (2) Mjetet për bursë gjyqësore sigurohen nga Buxheti gjyqësor.

#### Neni 72

- (1) Pushimet vjetore në gjykata zgjasin prej 15 korrik deri më 1 shtator.

(2) Gjatë kohës së pushimeve vjetore në gjykatat e shkallës së parë kryhen vetëm punët më të rëndësishme, edhe atë: hetime dhe gjykime në lëndë penale kur i akuzuari është në paraburgim dhe në lëndë penale të palëve të cilat nuk jetojnë në Republikën e Maqedonisë; lëndë për zbatimin e masave të përkohshme; padisë kambiale; kontesteve për botimin e korigjimit të informatës së botuar; lëndëve kundërvajtëse me karakter urgjent; lëndëve jashtëkontestimore dhe përmbaruese në lidhje me edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe obligimeve ndaj lëndëve për asistencë që dalin nga ligji; regjistrimin e partive politike, lëndëve jashtëkontestimore për mbajtjen e personave në institucion shëndetësor; regjistrimin e pronës së personit që ka lënë, përpilimit të testamentit, pranimit të shkresave dhe çështjeve të tjera që janë të lidhura me afate ligjore prekluzive.

(3) Gjatë kohës së pushimeve vjetore, në gjykatat e apelit veprohet sipas ankesave të vendimeve ndaj lëndëve nga paragrafi (2) të këtij neni, dhe ndaj lëndëve ndaj të cilave gjykohet në seanca të mbyllura.

(4) Përveç për punët nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, koha nga paragrafi (1) të këtij neni konsiderohet gjatë kohës kur gjykata nuk punon.

(5) Gjyqtari ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje prej 26 ditë pune.

## V. PUSHIMI DHE SHKARKIMI NGA FUNKSIONI I GJYQTARIT

### 1. Pushimi i funksionit gjyqtar

#### Neni 73

(1) Gjyqtarit i pushon funksioni gjyqtar, nëse:

- atë vetë e kërkon,
- përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit, që e përcakton Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë;
- i plotëson kushtet për pensionim në bazë të moshës;
- zgjidhet ose emërohet në funksion tjetër publik, përveç kur funksioni i gjyqtarit pushon nën kushte të përcaktuara me ligj dhe
- është i dënuar me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale në dënim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muajve.

(2) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në rastet e paragrafit (1) të këtij neni, verifikon pushimin e funksionit të gjyqtarit.

(3) Me ditën e pushimit të funksionit të gjyqtarit që e verifikon Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë mbi bazat e paragrafit (1) të këtij neni, gjyqtarit i pushon e drejta e rrogës.

### 2. Shkarkimi i gjyqtarit

#### Neni 74

(1) Gjyqtari shkarkohet nga funksioni i gjyqtarit:

- për shkak të shkeljes më të rëndë disiplinore që e bën të padenjë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit të përcaktuar me ligj dhe
- për shkak të kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(2) Vendim për shkarkimin e gjyqtarit merr Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

(3) Me ditën e shkarkimit të gjyqtarit nga ana e Këshilli gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, në bazë të paragrafit (1) të këtij neni, gjyqtarit i pushon e drejta e rrogës.



### **3. Kryerja e funksionit të gjyqtarit në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme**

#### Neni 75

(1) Me kryerjen e funksionit në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme nënkuptohet profesionalitet i pakënaqshëm ose pandërgjegjshmëri e gjyqtarit që ndikon në kualitetin dhe azhurnitetin në punë, edhe atë:

- nëse dy vjet me radhë Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë vlerëson se gjyqtari tregon rezultate të palakmueshme, veçanërisht me sjelljen e vendimeve gjyqësore jo në kohë, mbajtjen e procedurës në mënyrë joefikase dhe jo të azhurnuar, numrin e vendimeve gjyqësore të vërtetuara, të modifikuara dhe të anuluar,

- në mënyrë të pandërgjegjshme, jo në kohë ose në mënyrë të pakujdesshme kryen funksionin e gjyqtarit në mbajtjen e procedurës ndaj lëndëve të caktuara,

- mban procedurë gjyqësore në mënyrë të njëanshme veçanërisht në raport me trajtimin e barabartë të palëve,

- vepron ndaj lëndëve në kundërshtim me parimin e gjykimit në afatin e arsyeshëm, respektivisht shtyrjen e procedurës gjyqësore pa ekzistimin e bazës ligjore.

- lëshon informata të klasifikuara në mënyrë të paautorizuar;

- i bën publike informatat dhe të dhënat për lëndë gjyqësore për të cilat nuk është vendosur në mënyrë të plotfuqishme;

- shkelje të qëllimshme të rregullave për dënim të drejtë;

- keqpërdorim të pozitës ose tejkalim të autorizimeve zyrtare;

- cenim të dispozitave ose në mënyrë tjetër prishje të pavarësisë së gjyqtarëve gjatë gjykimit;

- cenim të rëndë të dispozitave të Kodeksit gjyqësor me të cilin rrënohet dinjteti i funksionit të gjyqtarit.

### **4. Shkelja e rëndë e disiplinës**

#### Neni 76

Shkelje e rëndë e disiplinës, për të cilën ngrihet procedurë për përgjegjësi disiplinore për shkarkim të gjyqtarit, konsiderohet:

1) shkelja e rëndë e rendit dhe e qetësisë publike me të cilin rrënohet autoriteti i tij dhe autoriteti i gjykatës;

2) cenim i rëndë i të drejtave të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, me çka rrënohet autoriteti i gjykatës dhe funksioni i gjyqtarit dhe

3) cenimi i parimit të mosdiskriminimit në çfarëdo lloj baze.

#### Neni 77

Si shkelje disiplinore, për të cilën ngrihet procedurë disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, për të cilën mund të kumtohet masa disiplinore konsiderohet:

1) thyerja e rendit të caktuar për veprim ndaj lëndëve;

2) pamundësimi i kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën gjyqësore nga ana e gjykatës më të lartë;

3) sjellja josolide dhe jo e denjë në vende publike;

4) mosmbajtja e togës gjyqësore;

5) marrja e dhuratave dhe të mirave të tjera në lidhje me punën gjyqësore;

6) aktivitetet politike dhe partiake (neni 52 paragrafi (6));

7) kryerja e funksionit tjetër publik, punë ose veprimtari që nuk është në pajtim me kryerjen e funksionit të gjyqtarit (neni 52 paragrafi (1), (2) dhe (3));

8) shkaktimi i prishjes më të rëndë të marrëdhënieve në gjykatë, të cilat në mënyrë të dukshme ndikojnë mbi kryerjen e funksionit të gjyqtarit;

- 9) mosplotësimi i obligimeve të mentorit dhe aftësimit profesional të bashkëpunëtorëve;
- 10) cenim më i rëndë i të drejtave për mungesë nga puna;
- 11) mosplotësimi i detyrës për arsimim profesional dhe
- 12) mosarritja e rezultateve të pritura në punë më shumë se tetë muaj të njëpasnjëshëm pa shkaqe të arsyeshme.

## 5. Masat disiplinore

### Neni 78

Për përcaktimin e shkeljes disiplinore të gjyqtarit, Këshilli mund të kumtojë një nga këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim,
- qortim publik dhe
- zvogëlimin e rrogës në lartësi prej 15% deri në 30% nga rroga mujore e gjyqtarit në kohëzgjatje prej një muaji deri në gjashtë muaj.

### Neni 79

(1) Kryetari i gjykatës shkarkohet nga funksioni i kryetarit, kur Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në procedurë do të konstatojë plotësimin e disa nga bazave si vijojnë:

- keqpërdorim të pozitës ose tejkallim të autorizimeve zyrtare,
- disponim të paligjshëm dhe jodestines të mjeteve financiare të gjykatës,
- moskryerje ose kryerje jo në kohë të punëve të administratës gjyqësore,
- ndikim mbi pavarësinë e gjyqtarëve në lidhje me vendosjen për lëndë të caktuara,
- shkakton prishje të rëndë të marrëdhënieve në gjykatë që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në punën e gjykatës,
- cenim të rregullave në lidhje me sistemimin e lëndëve dhe
- mosrealizim të programit të punës.

(2) Në rast të formës më të lehtë të cenimit të bazave nga paragrafi (1) të këtij neni, kryetari të gjykatës mund t'i kumtohet masë disiplinore.

### Neni 80

(1) Gjyqtarit-porotë i pushon funksioni:

- 1) nëse atë vetë e kërkon;
- 2) nëse përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e detyrës gjyqtar porotë;
- 3) nëse është i dënuar për vepër penale me dënim me burg prej së paku gjashtë muajsh;
- 4) nëse e kryen detyrën në mënyrë jo të rregullt dhe të pandërgjegjshme si gjyqtar-porotë dhe
- 5) me mbushjen e 60 vjetëve moshë.

(2) Procedurën për pushimin e funksionit të gjyqtarit-porotë e mban Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me propozim të kryetarit të gjykatës.

### Neni 81

Kur kundër gjyqtarit-porotë zhvillohet hetim ose është ngritur procedura për pushim funksioni, kryetari i gjykatës nuk do ta thërret të ushtrrojë funksionin gjyqtar-porotë.

## VI. ADMINISTRATA E DREJTËSISË

### Neni 82

(1) Punët e administratës së drejtësisë i kryen Ministria e Drejtësisë.

(2) Për kryerjen e punëve të administratës së drejtësisë, Ministria e Drejtësisë komunikon me kryetarin e gjykatës përkatëse.

#### Neni 83

Në fushëveprimin e administratës së drejtësisë përfshihet sigurimi i kushteve të përgjithshme për kryerjen e pushtetit gjyqësor, e veçanërisht përgatitja e ligjeve dhe dispozitave të tjera nga lëmi i organizimit dhe i punës së gjykatave dhe procedurave në gjykata, miratimi i rregullores gjyqësore, kujdesi për arsimimin dhe aftësimin profesional të kuadrove, sigurimin e kushteve materiale, financiare, të sigurisë, të lokaleve dhe kushteve të tjera për punën e gjyqtarëve, kryerjen e punëve të ndihmës juridike ndërkombëtare, ekzekutimin e dënimeve të kumtuara për vepra ndëshkuese, grumbullimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për punën e gjykatave, mbikëqyrjen e kryerjes në mënyrë të azhurnuar të punëve në gjykatë dhe zbatimin e rregullores gjyqësore, mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave për depozitat dhe garancitë gjyqësore, studimin e parashtesave dhe ankesave të qytetarëve për punën e gjykatave që kanë të bëjnë në shtyrjen e procedurës gjyqësore ose të punës së shërbimeve gjyqësore, si dhe detyrave dhe punëve të tjera administrative të përcaktuara me ligj.

#### Neni 84

(1) Ministri i Drejtësisë nxjerr Rregullore gjyqësore, sipas mendimit paraprak në seancën e përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë.

(2) Me Rregulloren gjyqësore përcaktohet organizimi i brendshëm i gjykatave, mënyra e punës së gjykatave, mbajtja e fletëregjistrimit dhe librave të tjerë, veprimi me shkresat, formularët, punën ndaj ndihmës juridike ndërkombëtare dhe veprimi ndaj parashtesave, thirrja dhe sistemimi i gjyqtarëve-porotë, vendosja e përkthyesve të përhershëm gjyqësor, të interpretuesve dhe personave ekspertë, mbajtja e statistikës dhe e evidencës dhe aftësimit profesional të kuadrove, rregullat për shenjat e veçanta të automjeteve gjyqësore, sistemin informativ në gjykata, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e gjykatave.

(3) Ministria e Drejtësisë bën mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e Rregullores gjyqësore.

#### Neni 85

(1) Ministri i Drejtësisë me vendim cakton përkthyes gjyqësorë dhe mban regjistër emëror.

(2) Kushtet që duhet t'i plotësojë kandidati që të caktohet përkthyes gjyqësor janë:

- të ketë shtetësinë e Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase,
- të ketë shkollim sipëror,
- të ketë vërtetim për zotërim aktiv të gjuhës së huaj,
- të ketë vendbanim, respektivisht vendqëndrim në territorin e gjykatës për të cilën kërkon të caktohet përkthyes gjyqësor.

#### Neni 86

(1) Ministria e Drejtësisë mban Regjistër zgjedhor gjyqësor, mban evidencë për policinë gjyqësore, për përkthyesit dhe interpretuesit gjyqësorë dhe për personat ekspertë.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) e këtij neni përmban të dhëna për mbiemrin dhe emrin, datën dhe vendin e lindjes, nacionalitetin, vendbanimin, arsimimin, llojin e arsimit, emrin profesional, njohjen e gjuhës së huaj, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara me ligj.

(3) Të dhënat nga paragrafi (2) të këtij neni gjykatat ia dorëzojnë Ministrisë së Drejtësisë në mënyrë të përcaktuar nga ministri i Drejtësisë.

(4) Të dhënat e shënuara në evidencë mund të shfrytëzohen vetëm për zbatimin e këtij ligji, si dhe ligjeve me të cilat përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe të punësuarve të tjerë në gjykatë, dhe me ato veprohet në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Neni 87

Personi, të dhënat e të cilit janë të regjistruara në evidencë, ka të drejtë të kërkojë këqyrje në të dhënat që kanë të bëjnë për atë dhe të kërkojë korrigjim nëse ato nuk janë të sakta.

### VII. ADMINISTRATA GJYQËSORE

#### Neni 88

(1) Kryetari i gjykatës e përfaqëson gjykatën, e organizon punën dhe ndërmerr masa për shkak kryerjes jo në kohë dhe jo në rregull të punëve në gjykatë.

(2) Kryetari i gjykatës siguron zbatimin e Rregullores gjyqësore.

(3) Kryetari i gjykatës e përcakton rendin e punëve në gjykatë pas sigurimit paraprak të mendimit nga seanca e gjyqtarëve dhe seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme.

(4) Me orarin vjetor për punë nga radhët e gjyqtarëve përcaktohet zëvendësi i kryetarit të gjykatës.

(5) Me orarin vjetor për punë nga radhët e gjyqtarëve përcaktohen kryetarë të njëjësive gjyqësore të specializuara dhe zëvendësit e tyre, dhe kryetarë të seksioneve gjyqësore dhe këshillave gjyqësore.

#### Neni 89

Në rast pushim mandati të kryetarit të gjykatës, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të gjykatës, funksionin kryerës i detyrës kryetar i gjykatës do ta ushtrojë zëvendësi i kryetarit të gjykatës.

#### Neni 90

Për kryerjen e punëve të caktuara administrative, financiare, operative, manipulative dhe ndihmëse për më shumë gjykata në të njëjtin vend, mund të themelohen shërbime të përbashkëta ose të caktohen punëtorë që do të bëjnë punë dhe detyra të përbashkëta.

#### Neni 91

(1) Në gjykata, në të cilat themelohen seksione gjyqësore të specializuara, sistemohen gjyqtarët sipas specializimit të tyre në sfera juridike.

(2) Me punën e seksionit gjyqësor të specializuar udhëheq kryetari i seksionit.

(3) Në seancën e seksionit gjyqësor të specializuar shqyrtohen çështje me interes për punën e të gjithë këshillave, respektivisht gjyqtarëve që janë në përbërje të seksionit, veçanërisht në raport me zbatimin e ligjeve në fusha adekuate, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përparimin e metodës së punës.

(4) Seancë të seksionit gjyqësor të specializuar thërrasin kryetarët e seksioneve me iniciativë të tyre ose me kërkesë të gjyqtarëve të seksionit ose të kryetarit të gjykatës kur do të konstatohet se veçanërisht në zbatimin e ligjit ekziston mosharmonizim midis këshillave të veçanta në seksion.

#### Neni 92

(1) Seancën e gjyqtarëve e përbëjnë të gjithë gjyqtarët në gjykatë.

(2) Në seancën e gjyqtarëve shqyrtohen çështje me rëndësi të përgjithshme për punën e gjykatës, përcaktohet programi për punë dhe jepet mendim për orarin vjetor për punën e gjyqtarëve dhe shqyrtohet raporti vjetor për punën e gjykatës dhe të Këshillit gjyqësor.

(3) Kryetari i gjykatës, në seancë të gjyqtarëve, mund të thërret edhe gjyqtarë-porotë kur shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e gjyqtarëve-porotë në gjykim.

#### Neni 93

(1) Nëpunësve gjyqësorë në gjykatë, kryetari i gjykatës u jep legjitimacione zyrtare.

(2) Ministri i Drejtësisë me rregullore i përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit dhe mënyrën e lëshimit dhe të heqjes së legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 94

(1) Gjyqtarët, gjyqtarët porotë, këshilltarët e lartë gjyqësorë, këshilltarët e pavarur gjyqësorë, këshilltarët gjyqësorë, bashkëpunëtorët profesionalë, praktikantët gjyqësorë, personat ekspertë gjyqësorë, interpretuesit, përkthyesit dhe personat tjerë të cilët marrin pjesë në procedurë dhe jashtë saj, janë të detyruar ta ruajnë nga zbulimi i paautorizuar informatën e klasifikuar me shkallë adekuate të fshehtësisë të përcaktuar në pajtim me ligjin, pa marrë parasysh si e kanë kuptuar.

(2) Obligimi për ruajtjen e informatës së klasifikuar nga zbulimi i paautorizuar zgjat në pajtim me ligjin.

#### Neni 95

(1) Kryetari i gjykatës, gjyqtarin ose personat e tjerë nga neni 94 paragrafi (1) të këtij ligji, mund t'i lirojë nga obligimi për ruajtjen e informatës së klasifikuar me shkallë adekuate të fshehtësisë, të përcaktuar në pajtim me ligjin.

(2) Për lirim nga obligimi për ruajtjen e informatës së klasifikuar me shkallë adekuate të mbrojtjes, për kryetarin e gjykatës në shkallë më të ulëta, vendim merr kryetari i gjykatës më të lartë të drejtpërdrejtë, ndërsa për kryetarin e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Re dhe për gjyqtarët e asaj gjykate, në pajtim me ligjin.

#### Neni 96

(1) Për shkak të natyrës së punës në gjykata organizohen kujdestari për kryerjen efikase të funksionit gjyqtar.

(2) Orarin dhe kohëzgjatjen e kujdestarive i miraton kryetari i gjykatës për secilin muaj. Për kujdestarinë e bërë paguhet kompensim. Me akt të ministrit të Drejtësisë përcaktohet lartësia e kompensimit për kujdestaritë.

#### Neni 97

(1) Informatë për publikun nëpërmjet mjeteve për informim publik për punën e gjykatës, si dhe informata për rrjedhën e procedurës ndaj lëndës konkrete, jep kryetari i gjykatës ose gjyqtari me autorizimin e tij.

(2) Kryetari i gjykatës dhe gjyqtari nga paragrafi (1) i këtij neni japin informata për publikun duke mbajtur llogari në atë që të mos cenohet autoriteti, nderi dhe dinjiteti i personalitetit dhe nëse ajo nuk është në dëm të pavarësisë dhe mëvetësisë së gjykatës.

(3) Në secilën gjykatë dhe vend të dukshëm për çdo ditë botohen të dhëna për numrin e lëndëve, gjyqtarëve, data, ora dhe salla e seancave të gjyqit në të cilën mbahet shqyrtimi.

(4) Secila gjykatë, së paku një herë në vit, publikisht e informon opinionin për rezultatet e punës së gjykatës dhe gjyqtarëve.

(5) Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën që është në vijim nuk guxojnë të japin informata dhe vlerësime për rrjedhën, mbajtjen dhe rezultatin e procedurës, nëse gjykata ka ndaluar të jepen informata të tilla.

### **Puna e gjykatës në kushte të grevës**

#### Neni 98

(1) Gjatë kohës së grevës së nëpunësve në gjykatë kryhen punët në lidhje me shqyrtimet e caktuara dhe seancat gjyqësore, respektivisht me seancat publike për marrjen dhe dërgimin e të gjitha vendimeve në afatin ligjor.

(2) Në procedurat për të cilat me ligj është përcaktuar se janë urgjente, respektivisht për punët që sipas ligjit dhe sipas natyrës së punëve janë të domosdoshme, gjykata është e detyrueshme të punojë edhe gjatë kohës së grevës.

## VIII. SISTEMI INFORMATIV GJYQËSOR

### Neni 99

(1) Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë formohet qendra për informatikë me bazën e të dhënave për Sistemin informativ gjyqësor.

(2) Gjykatat kanë shërbime për informatikë, si njësi të veçanta organizative.

(3) Me qendrën, respektivisht shërbimin për informatikë udhëheq kryetari i gjykatës ose gjyqtari i caktuar nga ai.

(4) Ministria e Drejtësisë siguron vendosjen, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit informativ në bazë të vetme metodologjike dhe teknologjike.

(5) Në Ministrinë e Drejtësisë vendoset qendër unike informatike me bazë të të dhënave për të gjitha organet e drejtësisë.

(6) Ministri i Drejtësisë, me akt nënligjor e përcakton mënyrën e funksionimit të sistemit informativ në gjykata nga paragrafi (1) dhe (5) të këtij neni.

## IX. SHËRBIMI PROFESIONAL GJYQËSOR

### Neni 100

(1) Gjykata e cila ka më shumë se shtatë gjyqtar ka sekretar.

(2) Sekretari i gjykatës udhëheq me shërbimin profesional gjyqësor dhe është përgjegjës për realizimin dhe për kryerjen e punëve profesionale dhe të punëve administrativo-teknike në gjykatë.

(3) Sekretari i gjykatës i ndihmon kryetarit të gjykatës në kryerjen e punëve të administratës gjyqësore.

(4) Sekretar mund të jetë juristi i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore, të ketë aftësi për kryerjen e detyrave me karakter udhëheqës dhe aftësi organizative, me provim të dhënë të jurisprudencës dhe me së paku pesë vjet përvojë pune pas dhënies së provimit të jurisprudencës për sekretar të Gjykatës Themelore, tetë vjet për sekretar të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

(5) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dhe Gjykata administrative kanë sekretar të përgjithshëm. Sekretar i përgjithshëm mund të jetë personi i cili i përmbush kushtet nga paragrafi (4) i këtij neni, me së paku 8 vjet punë në çështje juridike pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

### Neni 101

(1) Në gjykatat, varësisht nga vëllimi i punës së gjykatës, punësohen numër i caktuar i këshilltarëve të lartë gjyqësorë, të këshilltarëve të pavarur gjyqësorë, këshilltarëve gjyqësorë, bashkëpunëtorëve profesionalë, praktikantëve gjyqësorë, ashtu që çdo gjykatës ka së paku një nëpunës gjyqësor nga titujt e cekur.

(2) Në gjykatat, punësohen numër i caktuar i punëtorëve për kryerjen e punëve profesionale, administrative, teknike dhe punëve të tjera varësisht nga vëllimi i punës dhe nga nevojat e gjykatës.

(3) Gjatë punësimit të personave nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, pa i shkelur kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësimi i drejtë dhe përkatës i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

#### Neni 102

(1) Këshilltar i lartë gjyqësor në Gjykatën Themelore mund të jetë jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore, me provim të dhënë të jurisprudencës dhe me së paku pesë vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(2) Këshilltar i lartë gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Administrative mund të jetë juristi i diplomuar, i cili i përmbush kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni me së paku tetë vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(3) Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, këshilltar i lartë gjyqësor mund të jetë juristi i diplomuar, i cili i përmbush kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni me së paku 10 vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

#### Neni 103

(1) Këshilltar i pavarur gjyqësor në Gjykatën Themelore mund të jetë jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore, me provim të dhënë të jurisprudencës dhe me së paku tre vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(2) Këshilltar i pavarur gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Administrative mund të jetë personi, juristi i diplomuar, i cili i përmbush kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni me së paku gjashtë vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

(3) Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, këshilltar i pavarur gjyqësor mund të jetë personi, jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni me së paku tetë vjet punë në çështje juridike, pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

#### Neni 104

Këshilltar gjyqësor në gjykatë mund të jetë jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuar me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore dhe ka së paku dy vjet stazh pas provimit të dhënë të jurisprudencës.

#### Neni 105

Bashkëpunëtor profesional mund të jetë jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuar me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore me provim të dhënë të jurisprudencës.

#### Neni 106

(1) Praktikant gjyqësor mund të jetë jurist i diplomuar, i cili i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuar me Ligjin për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore.

(2) Praktikantët gjyqësorë punësohen në gjykatat e shkallës së parë dhe sistemohen në kryerjen e punëve dhe të detyrave me qëllim të fitimit të praktikës në të gjitha fushat e punës gjyqësore.

(3) Pas dhënies së provimit të jurisprudencës, praktikanti gjyqësor sistemohet në kryerjen punëve të bashkëpunëtorit profesional, sipas aktit për sistematizim.

(4) Praktikantit gjyqësor, i cili pas skadimit të stazhit të praktikantit, në afat prej dy vitesh nuk e jep provimin e jurisprudencës, i pushon cilësia e praktikantit në gjykatë.

#### Neni 107

Vendim për numrin dhe për detyrat e punës të këshilltarëve të lartë gjyqësorë, të këshilltarëve të pavarur gjyqësor, të këshilltarëve gjyqësor, të bashkëpunëtorëve profesionalë, të praktikantëve gjyqësorë dhe të punëtorëve të tjerë, merr kryetari i gjykatës në bazë të kriterëve të përcaktuar nga Këshilli buxhetor gjyqësor.

## X. MJETET PËR PUNË

### Neni 108

Mjetet për punën e gjykatave sigurohen nga Buxheti gjyqësor, si pjesë e veçantë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, e shënuar si “Pushtet gjyqësor”.

### Neni 109

(1) Lartësia e rrogave dhe e kompensimeve të tjera të gjyqtarëve në gjykatat, përcaktohen me ligj.

(2) Lartësia e rrogave dhe e kompensimeve të tjera të nëpunësve gjyqësorë dhe të të punësuarve të tjerë në gjykatat, përcaktohen me ligj dhe me marrëveshje kolektive.

(3) Rrogat dhe kompensimet tjera, si edhe armët, pajisja dhe uniforma e pjesëtarëve të policisë gjyqësore sigurohen nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të shënuara si “Pushtet gjyqësor”.

## XI. POLICIA GJYQËSORE

### Neni 110

Sigurimin e objekteve, të pronës, të personave dhe mbajtjen e rendit në gjykatën e bën policia gjyqësore.

### Neni 111

(1) Policia nuk mund të hyjë në hapësirën e gjykatës.

(2) Policia mund të hyjë dhe të qëndrojë në hapësirën e gjykatës vetëm kur arreston ose kur siguron person. Policia do të qëndrojë në hapësirën e gjykatës me kërkesë të gjyqtarit gjatë kohës së domosdoshme për sigurimin e personit.

(3) Policia mund të hyjë në hapësirën e gjykatës me ftesë të kryetarit të gjykatës ose të gjyqtarit në rastin e mungesës së tij, me qëllim të parandalimit të veprës penale ose kur kjo është më se e nevojshme për shkak të parandalimit të rrezikut të përgjithshëm.

### Neni 112

(1) Për kryerjen e punëve të policisë gjyqësore, mund të pranohet personi, i cili përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet t'i përmbushë edhe kushtet në vijim:

- 1) të mos jetë më i moshuar se 25 vjet, nëse punësohet për herë të parë;
- 2) të ketë aftësi fizike dhe psikike për kryerjen e punëve të policisë gjyqësore dhe
- 3) ta ketë kryer së paku shkallën IV të përgatitjes profesionale.

(2) Kontrollimin e kushteve për pranim dhe pranimin në punë, e bën Ministria e Drejtësisë me ç'rast, pa i shkelur kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësimi i drejtë dhe përkatës i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive.

(3) Ministri i Drejtësisë, me vendim e përcakton numrin e personave për kryerjen e punëve të policisë gjyqësore në çdo gjykatë.

### Neni 113

(1) Në gjykatat, me policinë gjyqësore udhëheq kryetari i gjykatës.

(2) Me policinë gjyqësore, në mënyrë të drejtpërdrejtë komandon shefi i policisë gjyqësore, i cili vepron sipas drejtimeve dhe udhëzimeve të kryetarit të gjykatës dhe ai ka zëvendës.

(3) Shef, përkatësisht zëvendësshef i policisë gjyqësore mund të jetë personi, i cili përveç kushteve nga neni 112 të këtij ligji, i përmbush edhe kushtet në vijim:

- të ketë shkallën VII të arsimit përkatës sipëror dhe



- të ketë së paku një vit përvojë pune si pjesëtar i policisë gjyqësore.

(4) Shefin, gjegjësisht zëvendëshefin e policisë gjyqësore e emëron kryetari i gjykatës nga radha e pjesëtarëve të policisë gjyqësore.

#### Neni 114

Pjesëtarët e policisë gjyqësore mbajnë uniformë të përcaktuar me shenjë të titullit dhe me shenja të tjera të veçanta dhe janë të armatosur në përputhje me rregullat për kryerjen e shërbimit.

#### Neni 115

(1) Gjatë kryerjes së punëve zyrtare, pjesëtarët e policisë gjyqësore mund të përdorin armë zjarri në gjykatë dhe rreth gjykatës, në rastet në vijim:

1) ta mbrojnë jetën e të pranishmëve në gjykatë;

2) të pengojnë arratinë e personit të gjetur në kryerje të veprës penale, e cila ndiqet me detyrë zyrtare, dhe nëse ekzistojnë baza të dyshimit se do të përdorë armë zjarri në gjykatë dhe rreth gjykatës;

3) të evitojnë nga vetja sulm të drejtpërdrejtë kundërligjor me të cilin rrezikohet jeta e tyre dhe

4) të evitojnë sulm mbi gjykatën.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, pjesëtarët e policisë gjyqësore do të përdorin armë zjarri vetëm nëse me përdorimin e forcës fizike, të shkopit të gomës ose të mjeteve të tjera të detyrimit nuk mund ta sigurojnë punën zyrtare.

#### Neni 116

Nëse mjetet e detyrimit dhe armët e zjarrit janë përdorur në suazat e autorizimit, përjashtohet përgjegjësia e pjesëtarit të policisë gjyqësore, i cili e ka përdorur mjetin ose armën e zjarrit.

#### Neni 117

(1) Për shkak të llojit, të natyrës dhe të ndërlikueshmërisë së punëve dhe të detyrave që kryhen nga pjesëtarët e policisë gjyqësore, shumica e mjeteve të dedikuara për ato detyra pune rritet deri në 20%.

(2) Pjesëtarëve të policisë gjyqësore u paguhet kompensim për punën e natës dhe për punën jashtë orarit të punës, në përputhje me ligjin dhe me marrëveshjen kolektive.

#### Neni 118

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nxjerr rregulla për armatosjen dhe për pajisjen e policisë gjyqësore, për titujt dhe për kushtet për fitimin e titujve, për shenjat për titujt dhe për uniformën.

(2) Autorizohet ministri i Drejtësisë t'i nxjerrë dispozitat për:

- rregullat e kryerjes së punëve të policisë gjyqësore,

- përdorimin e armës së zjarrit, të shkopit të gomës dhe të mjeteve të tjera të detyrimit,

- kohëzgjatjen e veshjes, të këpucëve dhe të pajisjes së veçantë personale,

- aftësitë psikofizike që duhet t'i posedojnë personat të cilët pranohen në punë dhe

- punën materiale me sendet e armatimit dhe me pajisjen e veçantë personale dhe raportet e brendshme në policinë gjyqësore.

### XIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 119

(1) Gjyqtarët e zgjedhur para hyrjes së këtij ligji në fuqi, vazhdojnë me kryerjen e funksionit të gjyqtarit.

(2) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e zbatimit të këtij ligji, do të marrë vendim për numrin e gjyqtarëve në Gjykatën themelore Shkupi I - Shkup dhe në Gjykatën themelore Shkupi II - Shkup.

(3) Risistemimin e gjyqtarëve në gjykatat nga paragrafi (2) i këtij neni do ta bëjë Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë më së voni në afat prej tre muajsh nga marrja e vendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke mbajtur llogari për specializimin e gjyqtarëve në çështje penale dhe civile.

#### Neni 120

Fillimi me punë dhe transferimi i lëndëve prej Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë në Gjykatën administrative do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për kontestet administrative.

#### Neni 121

Ministria e Drejtësisë do të sigurojë kushte hapësinore për funksionimin e Gjykatës administrative.

#### Neni 122

Seksionet e specializuara gjyqësore për gjykimin e veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe sektorët e specializuar gjyqësor të gjykatave do të formohen në afat prej 90 ditësh nga dita e zbatimit të këtij ligji.

#### Neni 123

Risistemimi dhe transferimi i lëndëve prej njëres gjykatë në gjykatën tjetër, sipas kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, do të bëhet më së voni në afat prej 120 ditësh nga dita e zbatimit të këtij ligji, në përputhje me Udhëzimin për mënyrën e ndërmarrjes së lëndëve, që e nxjerr ministri i Drejtësisë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

#### Neni 124

(1) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, lëndët e shkallës së parë për të cilat nuk është filluar procedura, ndërmerren nga ana e gjykatës kompetente lëndore dhe vendore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(2) Lëndët e filluara, për të cilat është marrë vendimi i shkallës së parë, i përfundojnë gjykatat ekzistuese kompetente lëndore dhe vendore.

(3) Lëndët, të cilat për shkak të ankesës janë kthyer në vendimmarrje të përsëritur, ndërmerren nga ana e gjykatave kompetente lëndore dhe vendore në përputhje me këtë ligj.

#### Neni 125

(1) Deri në nxjerrjen e rregullores gjyqësore sipas dispozitave të këtij ligji, vazhdon të zbatohet rregullorja gjyqësore ekzistuese në qoftë se nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Aktet nënligjore, për nxjerrjen e të cilave është autorizuar ministri i Drejtësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh prej ditës së zbatimit të këtij ligji.

(3) Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga paragrafi (2) i këtij neni, vazhdojnë të zbatohen aktet nënligjore të nxjerra para ditës së hyrjes së këtij ligji në fuqi.

#### Neni 126

(1) Deri në fitimin e parë të cilësisë të kandidatit për gjyqtar, në përputhje me Ligjin për Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve publikë, gjyqtarët e gjykatave themelore do të zgjidhen në përputhje me kushtet nga neni 43, paragrafi (1) dhe (2) i Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003).

(2) Në periudhë trevjeçare pas ditës së fitimit të parë të cilësisë së kandidatëve për gjyqtarë, në përputhje me Ligjin për Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve publikë, Këshilli gjyqësor, 50% të vendeve të lira, të përcaktuara për gjyqtar për gjykatat themelore, do t'i plotësojë me persona të cilët i përmbushin kushtet për gjyqtar të gjykatës themelore në përputhje me nenin 43, paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003) dhe të cilët nuk e kanë ndjekur trajnimin fillestar në Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve publikë.

#### Neni 127

Me ditën e zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për gjykatat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 36/95, 45/95 dhe 64/2003), përveç dispozitave nga neni 43 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit që do të pushojnë të vlejën pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 126 të këtij ligji.

#### Neni 128

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërsa do të fillojë të zbatohet prej datës 1 janar 2007.